

**AKT THEMELIMI DHE STATUT
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR:
“ADVENTURE & FUN ALBANIA – HIKING” Sh.P.K.**

**KREU I
EMËRTIMI, OBJEKTI I VEPRIMTARISË, SELIA, KOHËZGJATJA**

Neni 1: Data e themelimit, emri dhe themeluesi

Bazuar në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë dhe Ligjin nr.9901 datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” sot në datën 05.08.2024, unë ortaku i vetëm Evan Rroço, vendosa themelimin e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar me një ortak: Adventure and Fun Albania – Hiking Sh.P.K.

Themeluesi i shoqërisë dhe njëkohësisht dhe ortak i vetëm i saj është:

Evan Rroço lindur më 25 Korrik 1960 dhe banues në Tiranë në adresën Rruga Ismail Qemali, Ndërtesa 38, Hyrja 1, Njësia administrative Nr.2 Tiranë, me numër personal identifikimi: G00725066M

Neni 2: Objekti i shoqërisë

Objekti i shoqërisë është kryerja e aktivitetit të operatorit turistik për udhëtime të specialiteteve të veçanta.

Neni 3 : Kohëzgjatja

Shoqëria fillon ekzistencën e saj që në momentin e regjistrimit të saj në Qendrën Kombëtare të Biznesit. Shoqëria parashikohet të vazhdojë veprimtarinë për një afat të papërcaktuar.

Neni 4 : Selia

Selia e shoqërisë ndodhet në adresën: Rr. Papa Gjon Pali II, 11/1, 1010 Tiranë

**KREU II
KAPITALI**

Neni 5: Kapitali Themeltar

Kapitali themeltar i shoqërisë është 10.000 Lekë dhe përbëhet nga një kuotë e vetme. I gjithë kapitali është nënshkruar nga ortaku i vetëm Evan Rroço i cili zotëron 100% të tij (ose një kuotë).

Kontributi i ortakut do të jetë në para të cilat do të depozitohen në llogari bankare të shoqërisë në momentin që ajo fillon veprimtarinë dhe derdhja kërkohet nga administratori.



- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- ë) shpërndarjen e rezultatit të periudhës;
- f) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- g) kryerjen e investimeve strukturore;
- gj) pjesëtimin e kuotës dhe anulimin e saj;
- h) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- i) riorganizimin, prishjen, bashkimin dhe ndarjen e shoqërisë;
- j) çështje të tjera të parashikuara nga ligji.

Administratori nuk mund të veprojë si përfaqësues i ortakut në asamblenë e përgjithshme.

Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme nga një person i tretë në bazë të një autorizimi.


Neni 9: Administratorët: Emërimi, shkarkimi, të drejtat dhe detyrimet

1. Ortaku mund të emërojë/shkarkojë administratorët, vendosë afatet e ushtrimit të të drejtave dhe detyrimeve të tyre dhe caktojë shpërblimin e tyre. Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

2. Administrator i parë i shoqërisë është:

Z. Loren Rroço lindur më 20 Qershor 1992 dhe banues në Tiranë në adresën Rruga Ismail Qemali, Ndërtesa 38, Hyrja 1, Njësia administrative Nr.2 Tiranë, me numër personal identifikimi: J20620074D

Specimeni i nënshkrimit të tij është:



Neni 10: Kompetencat e administratorëve

Administratori/ët kanë të drejtë e detyrohen të:

- a) kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikën tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- b) përfaqësojnë shoqërinë;
- c) kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- ç) përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
- d) krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- dh) kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;

Administratorët janë të detyruar të thërrasin Asamblenë e Përgjithshme, në rastin kur sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.



Neni 6: Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit

1. Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet në se një gjë e tillë propozohet nga administratori duke argumentuar dhe domosdoshmërinë e tij në terma ekonomikë, dhe miratohet në parim dhe në vlerë nga ortaku i vetëm i shoqërisë.
2. Shtimi i kapitalit mund të bëhet në para nëpërmjet nënshkrimit të kuotave nga ortaku, ose dhe në natyrë. Shtimi i kapitalit në natyrë mund të bëhet vetëm në rastin kur shoqëria ka nevojë për elementin pasuror i cili propozohet të derdhet në natyrë. Vlerësimi i kapitalit të derdhur në natyrë bëhet bazuar në dokumentet verifikues të vlerës në blerje si dhe amortizimet eventuale të llogaritura në bazë të normativave ligjore në fuqi. Në çdo rast ortaku i vetëm duhet të bjerë dakord për vlerën e llogaritur të aktivitetit të kontribuar në natyrë, para se ai të shtohet në kapitalin e shoqërisë.
3. Zvogëlimi i kapitalit në parim, shuma si dhe mënyrat dhe procedurat e kryerjes vendosen nga ortaku i vetëm.

Neni 7: Transferimi i kapitalit

1. Kuota e kapitalit të shoqërisë dhe të drejtat që rrjedhin prej saj mund të fitohen ose të kalohen vetëm nëpërmjet:

- Kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- Shitblerjes;
- Trashëgimisë;
- Dhurimit;
- Çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

2. Personi që kalon kuotën dhe ai që e fiton atë përgjigjen në mënyrë solidare ndaj shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës, nga çasti i kalimit të kuotës, deri në çastin e regjistrimit të kalimit.

Regjistrimi i kalimit të kuotës kryhet nga shoqëria sipas nenit 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit"

KREU III

ORGANET VENDIMMARRËSE DHE DREJTUESE

Neni 8: Organi vendimmarrës

Ortaku i vetëm është i vetmi organ vendimmarrës i cili merr vendime në përputhje me statutin e shoqërisë si dhe ligjin 9901 date 14.04.2008 " Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" për ato raste të cilat nuk janë parashikuar në statut.

Ortaku është përgjegjës për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- ç) emërimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike;
- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;

Nëse asambleja e përgjithshme emëron më shumë se një administrator, ata e administrojnë bashkërisht shoqërinë.

Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë. Padi të, që lidhen me shpërbimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktuale me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Neni 11: Detyrimet e përgjegjësive të administratorëve.

Administratorët janë përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

Pasojat e marrëveshjeve të kryera prej tyre dhe të pamiratuara nga asambleja që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorëve.

Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", administratorët detyrohen:

1. a) të kryejnë detyrat e tyre të përcaktuara në ligj ose në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjedis;
 - b) të ushtrojnë kompetencat që u njihen në ligj ose në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;
 - c) të vlerësojnë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;
 - ç) të parandalojnë dhe mënjanojnë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personalë me ata të shoqërisë;
 - d) të ushtrojnë detyrat e tyre me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.
2. Administratorët gjatë kryerjes së detyrave të tyre, përgjigjen ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.
3. Nëse administratorët veprojnë në kundërshtim me detyrat dhe shkelin standardet profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, janë të detyruar të dëmshpërblejnë shoqërinë për dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojnë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratorët kanë barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkuara. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidare.
4. Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratorët janë të detyruar t'i dëmshpërblejnë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit „Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare“, kryejnë veprimet e mëposhtme:
- U paguajnë ortakëve interesa apo dividendë pa miratim të asamblesë;
 - Shpërndajnë aktivet shoqërisë;
 - Lejojnë që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet;

KREU IV
PRISHJA E SHOQËRISË, LARGIMI DHE PËRJASHTIMI I ORTAKËVE

Neni 12: Prishja e shoqërisë

1. Shoqëria mund të prishet në se ortaku i vetëm vendos për prishjen e saj. Gjithashtu shoqëria mund të prishet edhe për tërë rastet e tjera të parashikuara në ligjin Nr. 9901, datë 14.4.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".
2. Ortaku merr vendim me shkrim në të cilin parashikohet mënyra e likuidimit si dhe emrat e një ose më shumë likuidatorëve të shoqërisë.
3. Në se ortaku nuk merr vendim për emërimin e likuiduesve, caktimi i tyre kryhet në bazë të normativave ligjore në fuqi.

Neni 13: Baza ligjore

Shoqëria do të zhvillojë veprimtarinë e saj në përputhje të plotë me këtë statut. Për sa nuk parashikohet në të do të zbatohen dispozitat e ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

KREU V
MOSMARRËVESHJET

Neni 14

Të gjitha mosmarrëveshjet që lindin ndërmjet ortakëve si pasojë e mosplotësimit të normativave të këtij statuti si dhe të normativave ligjore në fuqi, zgjidhen nga Gjykata e Qytetit Tiranë.

O R T A K U

I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

"ADVENTURE AND FUN ALBANIA – HIKING" Sh.P.K.

EVAN RROÇO

Evan Rroço

